



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1103/16 Prot.

Tiranë, më 18.04.2023

V E N D I M

Nr. 30 datë 18.04 2023

**MBI MIRATIMIN E STUDENTËVE TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE QË
PËRJASHTOHEN 50% NGA TARIFA E SHKOLLIMIT,
PËR VITIN
AKADEMIK 2022-2023, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS**

Mbështetur në nenin 49 të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të VKM nr. 780 dt. 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimeve në programet e ciklit të dytë të studimeve, në IAL Publike", Vendimi nr. 55 datë 30.11.2022 "Për miratimin e dokumentacionit , për përfitimin e bursës ose të përjashtimit nga tarifa e shkollimit për studentët e çit të parë dhe përjashtimin nga tarifa e shkollimit 50% për studentët e ciklit të dytë , për vitin akademik 2022-2023", Relacionin e komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit nr. 246/2 datë 07.04.2023, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 18 .04.2023,


V E N D O S I:

1. Të miratojë listën shtesë të studentëve që ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve, program i parë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për tu përjashtuar 50% nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2022-2023, shtojca 1 bashkëngjitur.
2. Të miratojë listën shtesë të studentëve që ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve, program i parë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për tu përjashtuar 50% nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2022-2023, shtojca 2 bashkëngjitur.
3. Ky vendim dërgohet në MAS bashkë me listën e studentëve të ciklit të dytë, program i parë që përjashtohen 50% nga tarifa e shkollimit , për vitin akademik 2022-2023.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen ëëë.ust.edu.al dhe tek trasparenca.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI



Shtojca 1

Lista e studentëve që ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve, program i parë në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për tu përjashtuar 50% nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2022-2023.

Kriteri Nr. 2 Student që vjen nga shtresa sociale : Student fëmijë të personave /familjes me aftësi të kufizuar , të vërtetuar me Vendim të KMC-A për punë , familjet e të cileve trajtohen/përfitojnë nga Ligji nr 9355 datë 10.03.2015 . Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore të ndryshuar , ndihmën ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë vetëqeverisjes vendore .

| Nr . | Nr. matrikullimi | Emër Mbiemër | Fakulteti | Programi | Viti | Përfitues i përjashtimit | Efekti Financiar i përjashtimit |
|--------------|------------------|--------------|-----------|-------------|------|--------------------------|---------------------------------|
| 1 | EF813B110047 | E.D | FSH L | MEFSH -B | 1 | Po | 52.500 |
| Shuma | | | | | | | 52.500 |

Shtojca 2

Lista e studentëve që ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve, program i parë në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për tu përjashtuar 50% nga tarifa e shkollimit , për vitin akademik 2022-2023.

Kriteri Nr. 3 Student që vjen nga shtresa sociale : Studentet që familjet e të cileve trajtohen/përfitojnë ndihme ekonomike të plote apo të pjesshme nga njësitë baze të vetëqeverisjes vendore .

| Nr | Nr. matrikullimi | Emër Mbiemër | Fakulteti | Programi | Viti | Përfitues i përjashtimit | Efekti Financiar i përjashtimit |
|--------------|------------------|--------------|-----------|-------------|------|--------------------------|---------------------------------|
| 1 | EF813B110022 | A. S | FSHL | MEFSH- B | 1 | Po | 52.500 |
| Shuma | | | | | | | 52.500 |